



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, BUJQËSISË, MBROJTJES CIVILE DHE
KONSUMATORIT
SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

PROJEKT-VENDIM

Nr. 01 datë 16.10.2023

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 34, DATË 19.10.2017 “PËR MIRATIMIN E
LINJAVE TË RREGULLTA RRETHQYTETËSE TË TRANSPORTIT TË
UDHËTARËVE ”**

Mbështetur në nenin 23, pika 6, nenin 54, germa “k”, nenin 55, pika 2 të Ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Në nenet 15, 19 të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar; Udhëzimin nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar, **i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës**, ku në mbledhjen e datës _____ 2023 të

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimin e VKB nr. 34, datë 19.10.2017 “Për miratimin e linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve” pika 3, konkretisht

Është:

Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Vau Dejës - Shllak**, nisja nga ora 7⁰⁰ - 12:30⁰⁰ me 2 (dy) orare në ditë **kthimi nga Shllaku** nga ora 09⁰⁰ - 14:30⁰⁰ me 2 (dy) orare në ditë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qytetin Vau Dejës tek sheshi Nënë Tereza (sipas planimetrisë) dhe në njësinë administrative Shllak në qendër të fshatit Shllak (sipas planimetrisë).

Të bëhet:

Për miratimin e linjës së rregullt të transportit të udhëtarëve **Vau Dejës - Shkodër - Shllak**, nisja nga ora 7⁰⁰ - 12:30⁰⁰ me 2 (dy) orare në ditë **kthimi nga Shllaku** nga ora 09⁰⁰ - 14:30⁰⁰ me 2 (dy) orare në ditë.

Stacionet për këtë linjë të jenë në qytetin Vau Dejës tek sheshi Nënë Tereza (sipas planimetrisë) dhe në njësinë administrative Shllak në qendër të fshatit Shllak (sipas planimetrisë).

HARTOI PROJEKT-VENDIMIN
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, BUJQËSISË, MBROJTJES CIVILE DHE
KONSUMATORIT

Konceptoi:
Sander Vathaj

Miratoi:
Elvis Preçi

KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Gjovalin Zefi



Konfirmoj Bazën Ligjore

Drejtorja Juridike

Juriste

Stefani Jaku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, BUJQËSISË, MBROJTJES CIVILE DHE
KONSUMATORIT
SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot

Vau Dejës, me ____/____/2023

RELACION

Drejtuar: Kryetarit të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës **Z. Ervis Shimaj**

Ndryshimi i VKB Nr.34, datë 19.10.2017 “Për miratimin e linjave të rregullta rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve” propozohet bazuar në kërkesën e subjektit Ndoc Tusha.

Kërkuesi është mbajtës i licencës për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse Vau Dejës – Shllak, por gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij, ka qenë objekt i ndëshkimit administrativ me gjobë për shkak se në licencë nuk është cilësuar kalimi nëpërmjet Shkodrës.

Prandaj kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij ndryshimi ku subjekti të ketë të drejtë kalimi nëpër Shkodër, por nuk ka të drejtë të zbresi apo të marrë qytetarë në këtë pikë kalimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Konceptoi:

Specialist/ Sektori i Shërbimeve Publike

Sander Vathaj

Miratoi:

Drejtor/ Drejtorja e Shërbimeve Publike, Bujqësisë, Mbrojtjes Civile dhe Konsumatorit

Elvis Preçi